REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E SHTIMES

MUNICIPALITY OF SHTIME/ OPSTINA STIMLJE

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

/KANCELARIJA PRESEDNIKA OPSTINE/MAYOR'S OFFICE

ZYRA PËR INFORMIM/ INFORMATION OFFICE/ KANCELARIJA ZA INFORMISANJE

Shtime, më 26 janar 2024

Nr. i Protokollit: 02-32

# Raporti për konsultime/dëgjime dhe takime publike të mbajtura gjatë vitit 2023

Komuna e Shtimes gjatë vitit 2023, ka organizuar gjithsej 9 konsultime, **9** dëgjime buxhetore dhe **2** takime publike me qytetarë, organizimi i konsultimeve, dëgjime dhe takime publike është bërë duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës dhe Udhëzimin Administrativ 06/2018 për Standarde Minimale të Konsultimit Publik në Komuna.

## Dokumentet për të cilat janë mbajtur konsultim publik janë:

**Gjatë vitit 2023 janë mbajtur këto konsultime publike:**

- Diskutim publik me qytetarë për Rregulloren Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2023, më 16 janar 2023;
- Konsultim publik me qytetarë për Draft-Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje 2023-2025, më 7 prill 2023;
- Konsultim Publik me qytetarë për Draft-Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, më 12 prill 2023;
- Konsultim publik për Draft-Planin Komunal për Integritet, më 13 prill 2023;
- Konsultim publik me qytetarë për Draft-Programin Trevjeçar për Banim Social, më 29 qershor 2023;
- Debat publik me qytetarë për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave, më 16 nëntor 2023;
- Konsultim publik me qytetarë për Draft-Rregulloren për Procedurat dhe Kriteret për Zgjedhjen e Laureatëve të Vitit në Sport, më 18 dhjetor 2023;
- Konsultim publik me qytetarë për Draft-Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2024-2027, më 15 dhjetor 2023;
- Diskutim publik me qytetarë për Draft-Rregulloren për Përcaktimin e Procedurave për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës Komunale për më pak se një vit, më 19 dhjetor 2023;

**Janë mbajtur 7 dëgjime publike për Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2024-2026, në këto vendbanime:**

(Diskutim publik me qytetarë për Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) 2024-2026, më 13.6.2023, 14.6.2023, 15.6.2023, 16.6.2023, 19.6.2023, 20.6.2023, 21.6.2023)

- Pjetërshticë
- Zborc
- Carralevë
- Lagje e Pajtimit
- Godanc
- Vojnovc
- Muzeqinë
- Gllavicë
- Rashincë
- Davidofc
- Belinc
- Shtime (Bashkësitë I, II, III, IV dhe V)
- Reçak
- Petrovë
- Mollopolc
- Klubet sportive-OJQ-të
- Bizneset
- Subjektet politike

**Ndërsa për projekt Buxhetin e vitit 2024 janë mbajtur 2 dëgjime publike buxhetore.** Njëri dëgjim buxhetor është mbajtur më 21 shtator 2023 me grupe të nënpërfaqësuara (Gra, të rinj, pensionistë, përsona me aftësi të kufizuara etj). Ndërkaq, dëgjimi i dytë publik buxhetor i përgjithëshëm me qytetarë të komunës së Shtimes është mbajtur më 22 shtator 2023.

Të dy këto konsultime buxhetore janë mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Shtimes.

**-Janë mbajtur edhe dy takime publike me qytetarë**, ku kryetari i Komunës, Qemajl Aliu ka raportuar për gjashtëmujorin e parë të punës së tij, ndërsa në fundvit është mbajtur edhe mbledhja dytë publike, ku është raportuar për punën e tij dhe të ekzekutivit gjatë vitit 2023.

(Takim publik me qytetarë i kryetarit të Komunës së Shtimes, më 30 qershor 2023);

(Takimi i dytë publik me qytetarë i kryetarit të Komunës së Shtimes, më 28 dhjetor 2023).

Njoftimet për organizimin e konsultimeve publike janë bërë me kohë ashtu siç është e përcaktuar me dokumentet e lartcekura më lartë, njoftimet janë publikuar në uebfaqen zyrtare të komunës, në vegëzat:

https://kk.rks-gov.net/shtime/category/konkurset-njoftimet/konsultime-publike/?page=2023

https://kk.rks-gov.net/shtime/category/konkurset-njoftimet/mbledhjet-publike-dhe-debatet/?page=2023

https://kk.rks-gov.net/shtime/category/degjimet-publike/njoftimet-degjimet-publike/?page=2023

Njoftimet janë publikuar edhe në Platformën e Konsultimeve Publike në vegëzën:

https://konsultimet.rks-gov.net/consultations.php?InstitutionID=20532&OpenPage=0&ClosedPage=0

https://konsultimet.rks-gov.net/consultations.php?InstitutionID=20532&OpenPage=0&ClosedPage=0

Gjithashtu njoftimet janë publikuar edhe në rrjetin social facebook të komunës.

Për mbajtjen e konsultimeve publike janë përgatitur procesverbale, të cilat janë publikuar në vegzën:

https://kk.rks-gov.net/shtime/category/degjimet-publike/procesverbalet-per-degjimet-publike/?page=2023

https://kk.rks-gov.net/shtime/ëp-content/uploads/sites/28/2023/09/Procesverbal-nga-mbledhja-publike-me-qytetare-e-kryetarit-per-punen-e-tij-ne-gjashtemujorin-e-pare-te-vitit-2023-1.pdf

https://kk.rks-gov.net/shtime/ëp-content/uploads/sites/28/2024/01/Procesverbal-nga-mbledhja-e-dyte-publike-me-qytetare-per-Raportin-e-Punes-se-kryetarit-te-komunes-se-Shtimes-Qemajl-Aliu-per-vitin-2023-2.pdf

Gjithashtu janë përgatitur edhe raporte për konsultime publike, raportet janë publikuar në vegëzën:

https://kk.rks-gov.net/shtime/category/degjimet-publike/raportet/?page=2023

https://kk.rks-gov.net/shtime/ëp-content/uploads/sites/28/2024/01/Raporti-i-punes-se-kryetarit-te-Komunes-se-Shtimes-Qemajl-Aliu-per-vitin-2023.pdf

Për të gjitha këto konsultime publike, dëgjime publike dhe takimet publike, të gjitha janë të dëshmuara edhe ne uebfaqën e komunës së Shtimes.

**Përgatiti: Lulzim Sahiti**

Zyrtar Përgjegjës për Konsultime Publike